



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UJËSJELLËS KANALIZIME KAMËZ SH.A

Tiranë, më \_\_\_\_\_ 2024

**PROCESVERBAL**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Kancelarie**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):kancelari

Në bazë të nenit 21, pika 2, nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , i ndryshuar, autoriteti kontraktor Ujesjelles Kanalizime Kamez sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

Njësia e Prokurimit "Procedurë e Hapur e thjeshtuar –Mallra në mbështetje të dispozitave ligjore sa më sipër cituar argumenton vendosjen e kriterëve si më poshte vijon:

Për realizimin e objektit të prokurimit Autoriteti Kontraktor kërkon nga Operatoret ekonomik dokumentat si më poshtë:

**1. Formularin e Ofertës.**

**2. IBAN nga Banka.**

**Argumentimi:**Kërkesat e mësipërme bazohen në ligjin nr.162/2020 “Per prokurimin publik”si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**3. Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të**

konfirmuara në vertetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. **Vërtetim ky, i marrë jo më parë se 30 ditë nga data e hapjes së ofertave.**

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur referuar nenit 40 pika 7 germa a), të VKM-se Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter ka për qëllim që në konkurim të jenë OE të cilët paguajnë rregullisht detyrimet për energjinë elektrike.

4. Vërtetim që Operatori Ekonomik ka shlyer detyrimet tatimore (taksa dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore të 3 muajve të fundit).

**Argumentimi:** Kriteret e mesiperme përmbajnë listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 të LPP-së, nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”. Është vendosur ky kriter për të garantuar AK se OE ushtron veprimtarinë e tij duke përmbushur detyrimet sipas legjislacionit tatimor në Republikën e Shqipërisë.

5. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave Vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKR-se.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.

Kriteri i taksave vendore është menduar të vendoset si kriter kualifikues për të garantuar AK se OE ushtron veprimtarinë e tij duke përmbushur detyrimet ndaj pushtetit vendor të njësisë territoriale ku ai ushtron aktivitetin e tij.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

**Argumentim:** Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” .

Specifikimet teknike janë përshkrimi i zerave të preventivit. AK ka dhënë specifikime të detajuara teknike sipas mallrave që kerkohen, lehtësisht të identifikueshme dhe me treg të gjere.

Dokumentacioni do të paraqitet në origjinal ose kopje e noterizuar.

Në të gjitha rastet kur përmendet ,markë ,emër i veçantë ,patentë ,vizatim ose tip,origjine specifike ,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

## **Njesia e Prokurimit**